



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

VENDIM

Nr. 89, datë 23/04/2019

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE
“PËR DIXHITAL-DIVIDENTIN”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------|-----------|
| - Znj. Anila Denaj | kryetare; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - Znj. Etleva Haka | anëtare; |
| - Znj. Mirjana Zisi | anëtare. |
| - Z. Ahmet Maçellari | anëtar; |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 23 /04 /2019, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore” i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, morri në shqyrtim kërkesën e Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me zbatimin e ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar.

I. Procedura

- (1) Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me shkresën nr. 1317, datë 26.03.2019 në bazë të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit” kërkoi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë miratimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore të përdorimit të ndihmës shtetërore sipas ligjit nr. 34/2017. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 6307/1, datë 5.04.2019 i kërkoi Autoritetit të Mediave Audiovizive që në cilësinë e dhënësit të ndihmës të njoftojë skemën e ndihmës shtetërore në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar të shoqëruar me Formularin Bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore në Aneksin 1 të VKM nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”. AMA me shkresën nr.1489, datë 9.4.2019 “Njoftim i ndihmës shtetërore” dërgoi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore. Në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar MFE kërkoi informacion shtesë të nevojshëm për vlerësim nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

II. Përshkrimi i masës

- (2) *Objektivi:* Plani i njoftuar i ndihmës shtetërore synon të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve TV, transmetuar nëpërmjet rrjeteve tokësore edhe pas

kalimit të plotë në transmetimet numerike, nëpërmjet kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë që shkakton kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike.

(3) *Baza ligjore:*

- Ligji nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të dixhital – dividendit”, Neni 6 “Ndarja dhe përdorimi i kompensimit financiar”, parashikon se:

Masa e kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, do të ndahet dhe do të përdoret si më poshtë:

1. 1/5 e tij do të përdoret për të mbuluar pjesërisht tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues lokalë/rajonalë në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve me experience në transmetime numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

3. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analoge në numerike.

- Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;

(4) *Kohëzgjatja:* Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2019.

(5) *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Autoriteti i Mediave Audiovizive.

(6) *Përfituesit:* Përfitues nga kjo skemë janë :

- operatorët ekzistues lokalë/rajonalë në rrjetin numerik të RTSH-së, të cilëve iu mbulohet një pjesë e kostos së tarifës për mbështetjen e transmetimeve të rrytë në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
- operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike që kompensohen për mbulimin e pjesshëm të investimeve që dalin jashtë funksionit si rezultat i ndryshimeve teknologjike sipas ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- operatorët privatë historikë kombëtarë që kompensohen për mbulimin e pjesshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analoge në numerike.

(7) *Implementimi i procesit të digjitalizimit:* Strategjia parashikon që implementimi i procesit të kalimit në transmetimet numerike do të kryhet sipas rendit dhe afateve të përcaktuara allotment pas allotmenti (metoda e ishujve numerikë) deri në mbulimin e plotë të territorit shqiptar (11 allotmente). Mbyllja e transmetimeve analoge konsiderohet si faza e parë dhe imediate e procesit digjitalizimit. Për arritjen e tij, kërkohet zbatimi i tre komponentëve të mëposhtëm, secili me mision dhe karakteristika të ndryshme:

1. Digjitalizimi i rrjeteve analogë tokësorë të transmetuesit publik.
2. Digjitalizimi i rrjeteve analogë tokësorë të operatorëve privatë kombëtarë.
3. Digjitalizimi i rrjeteve analogë tokësorë të operatorëve ekzistues lokalë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

(8) Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson se plani i ndihmës shtetërore lidhet me një

ndihmë operationale dhe përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

- (9) Neni 4, pika 1 ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, shtrëmbëron ose kërcënon të shtrëmbërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”

- (10) Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹ përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

- (11) Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik dhe selektiviteti dhe c) efekti në konkurrencë dhe tregti.
- (12) Komisioni vëren se skema e njoftuar e ndihmës aktivizon burime shtetërore, duke qenë të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e licencës së miratuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për dhënien e të drejtave të përdorimit, sipas neneve 68 dhe 69 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar do të kalojnë në llogari të Autoritetit të Mediave Audiovizive. AMA është një autoritet publik rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, i krijuar me ligjin nr. 97/2013, i cili vepron në emër të shtetit shqiptar dhe në interpretim të nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar konsiderohet një dhënës i ndihmës shtetërore.
- (13) Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore arrin në përfundimin se masa, përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

- (14) Referuar përputhshmërisë me nenin 13 (c) të Ligjit nr.9374/2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, skema e ndihmës mund të lejohet nëse:

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare”.

“lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

Në mënyrë që masa e ndihmës shtetërore të jetë në përputhje me nenin 13 e ligjit të ndihmës shtetërore, ndihma duhet të jetë në përpjesëtim me objektivin, të jetë e justifikuar dhe nuk duhet të shtrembërojë konkurrencën aq sa është në kundërshtim me interesin e përbashkët.

Komisioni vlerëson se plani i njoftuar i ndihmës shtetërore është në përputhje me nenin 13, shkronja c) e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 10, 17, 22, dhe 31 të Ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI :

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 34/2017 “Për lirin e frekuencave të dixhital – dividendit”. Vlera e ndihmës shtetërore e dhënë në këtë skemë është shumë totale e ndihmës e dhënë për procesin e kalimit të transmetimeve numerike në Republikën e Shqipërisë.
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e dhënësit të ndihmës të përcaktojë qartë mënyrën e pagesës, e cila duhet të jetë në zvogëlim dhe e limituar në kohë.
3. Autoriteti i mediave audiovizive brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.
4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
5. Ky vendim të botohet në fletoren zyrtare.

KRYETAR

ANILA DENAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 240, datë 4.4.2019

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E KOMPENSIMIT
FINANCIAR TË OPERATORËVE ME EKSPERIENCË
NË TRANSMETIMET NUMERIKE DHE OPERATORËVE PRIVATË
HISTORIKË KOMBËTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr.34/2017, “Për lirimin e frekuencave të dixhital-dividentit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Ndarjen e kompensimit financiar për kategoritë operatorë privatë historikë kombëtarë dhe operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike, si më poshtë vijon:
 1. Operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjeshëm të investimeve që dalin jashtë funksionit si rezultat i ndryshimeve teknologjike, sipas ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 2. Operatorët privatë historikë kombëtarë të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjeshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike.
 3. Vlera e kompensimit për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike do të llogaritet me përqindjen që vlera financiare për përgjegjësitë tatimore, e paguar prej secilit operator, zë në totalin e vlerës

financiare për përgjegjësitë tatimore të paguara nga të gjithë operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

4. Vlera e kompensimit për operatorët historikë kombëtarë do të ndahet në mënyrë të barabartë.

5. Operatori me eksperiencë në transmetimet numerike, për të përfituar kompensimin financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Relacionin e vlerësimit të firmosur dhe vulosur nga një ekspert kontabël i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, mbi përgjegjësinë tatimore të paguar pas datës 4 prill 2013 e deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Relacioni duhet të përfshijë informacion për masën e paguar nga subjekti për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi pagat dhe kontributet për të punësuarit, taksat kombëtare, tarifatat sipas llojit të ushtrimit të aktivitetit, tatimin e mbajtur në burim ku deklarohen (dividenti, tatimi mbi qiradhënie, shërbimet teknike etj.), taksat lokale e akcizën, dhe duhet të depozitohet në AMA, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i këtij të fundit. Në të kundërt, vlerësimi i masës së përgjegjësisë tatimore të paguara prej subjekteve përfituese do të përcaktohet nga AMA, bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare vjetore të depozituara pranë AMA-s.

c) Vërtetim lëshuar prej organeve tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

ç) Vërtetim lëshuar prej organeve përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

6. Operatori privat historik kombëtar, për të përfituar kompensimin financiar, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Dokumentacionin financiar për investimet e kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike, (përshtatjen e pajisjeve ekzistuese, instalimin e pajisjeve të reja të sistemit të

transmetimit) etj., si fatura tatimore blerjeje, fatura zhdoganimi, kontrata shërbimi.

- c) Vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- ç) Vërtetimin e lëshuar nga organet përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

7. Autoriteti i Mediave Audiovizive shqyrton dokumentacionin e subjekteve dhe kryen veprimet, si më poshtë vijon:

- a) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare të pashlyera ndaj saj.
- b) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare për sanksione gjobë të shndërruara në titull ekzekutiv.
- c) Verifikon nëse subjektet përdorin frekuenca pa autorizimin/licencimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

8. Autoriteti i Mediave Audiovizive kryen pagesën për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorët historikë kombëtarë pas plotësimit të kërkesave sipas këtij vendimi.

II. Ngarkohet Autoriteti i Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

NR.PROT.1386/1
DATË 18.4.2019

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

